



AMNISTIA E LIGJSHME E MILIONAVETË KUNDËRVAJTJEVE

(Analizë e veçantë e trajtimit të lëndëve
të kundërvajtjeve në gjykatat e Kosovës)

Autor: Arrita Reznici

Redaktorët: Betim Musliu, Ehat Miftaraj dhe Yll Zekaj

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Rrustem Statovci

Prishtinë

E: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

Përkrahur nga:



**National Endowment
for Democracy**

Supporting freedom around the world

Nëntor 2019

Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbajtja

1. Përmbledhja ekzekutive	4
2. Metodologjia	6
3. Mandati ligjor në ndjekje dhe gjykim të kundërvajtësve	7
4. Analizë përshkuese e inicimit të procedurave kundërvajtëse në Gjykatat Themelore nga institucionet kompetente.....	10
4.1. Policia e Kosovës.....	11
4.2. Inspektorët qendrorë dhe komunalë.....	13
4.2.1. Gjobat kundër ndotësve të mjedisit.....	13
4.2.2. Gjobat kundër shkelësve të Ligjit për Kontrollin e Duhanit	15
5. Ngarkesa e Gjykatave me lëndë të kundërvajtjeve përgjatë viteve 2016, 2017 dhe 2018.....	17
6. Parashkrimi i lëndëve të kundërvajtjeve në gjykatat themelore të Kosovës	17
6.1. Lëndët e kundërvajtjeve të pazgjidhura në fund të vitit në të gjitha gjykatat e vendit përgjatë viteve 2016, 2017 dhe 2018, të shprehura në përqindje (%)	18
6.2. Efikasiteti i gjykatave në trajtimin e lëndëve të kundërvajtjeve	21
6.3. Numri i lëndëve kundërvajtëse të parashkruara përgjatë viteve 2016, 2017 dhe 2018.....	26
6.4. Numri i lëndëve kundërvajtëse të parashkruara brenda një dite pune ne gjykatat e vendit	29
6.5. Roli i KGJK – së dhe masat e ndërmarra kundrejt parashkrimit të lëndëve të kundërvajtjes.....	33
7. Humbjet e shtetit nga parashkrimet e lëndëve kundërvajtëse	38
8. Gjetjet lidhur me trajtimin e rasteve të kundërvajtjes nga gjykatat në vendin tonë	40
9. Rekomandimet	42

1. Përmbledhja ekzekutive

Kundërvajtjet përbëjnë një nga shkeljet më të shpeshta që ndodhin në përditshmërinë e qytetarëve të Republikës së Kosovës. Kësisoj, edhe trajtimi i tyre nga institucionet gjegjëse duhet të bëhet me efikasitet, në mënyrë që të evitohen mundësitë që këto lëndë të parashkruhen, duke marrë për bazë afatet e shkurta të parashkrimit të këtyre rasteve.

Trajtimi i lëndëve të kundërvajtjes, po ashtu kërkon administrim dhe menaxhim efikas të lëndëve, koordinim dhe bashkëpunim në mes të institucioneve ligj zbatuese dhe gjykatave, që në praktikë po dëshmohej e kundërta. Fatkeqësisht, praktika tregon se këto raste nuk trajtohen dhe zgjidhen me kohë, e rrjedhimisht vjen deri tek parashkrimi i tyre. E nga kjo rrjedhin pasoja të tjera, si mos mundësia e shtetit që t'i sjell para përgjegjësisë personat që bien ndesh me ligjin dhe dëmi në buxhetin e shtetit si rezultat i mos arkëtimit të mjeteve nga kryesit e kundërvajtjeve. Si rezultat i mos efikasitetit të gjykatave në tërë territorin e Kosovës, vetëm në tre vitet e fundit, janë parashkruar mbi 170,000 lëndë kundërvajtëse.

Në Kosovë numrin më të madh të kundërvajtjeve del se e shqiptojnë Policia e Kosovës. Gjobat e shqiptuara nga ky institucion për kundërvajtje në trafik në vitin 2018 patën shënuar rritje në krahasim me dy vitet paraprake. Megjithatë, ka edhe institucione të tjera përgjegjëse për shqiptimin e gjobave për kundërvajtje. Në këtë grup hyjnë inspektoratet komunale dhe ato qendrore, të cilat tregojnë se nuk kanë qenë të kënaqur me punën e gjykatave. Madje, për më tepër, qasja e institucioneve të drejtësisë ka bërë që të dekurajohen dhe të ndjejnë se autoriteti i tyre është dëmtuar. Me këtë qëndrim të tyre nuk është se pajtohen gjykatat.

Viti 2018 ka shënuar një rënie në efikasitetin real të gjykatave kundrejt zgjidhjes së rasteve të natyrës kundërvajtëse. Edhe më karakteristike këtë rënie të efikasitetit e bën fakti se në vitin 2018 numri i lëndëve kundërvajtëse të pranuar në punë nga këto gjykata ka qenë në numër shumë më të vogël sesa në dy vitet paraprake, si rrjedhojë e Ligjit të ri për Kundërvajtje, i cili i ka dhënë kompetenca edhe organeve administrative që të merren me lëndë të kundërvajtjeve.

Ndryshimi i këtij ligji ka qenë pikë diskutimi për një kohë të gjatë, pikërisht për këtë autorizim të dhënë ndaj organeve administrative. Avokati i Popullit si institucioni më i zëshëm, pati deklaruar se ky ligj është jo kushtetues dhe i shkel të drejtat e njeriut. Megjithatë, pas një kohe pezullimi të atyre dispozitave, Gjykata Kushtetuese kishte dhënë mendimin se dispozitat e kontestuara janë kushtetuese dhe nuk paraqesin shkelje për të drejtat e njeriut, me ç'rast edhe ishin fuqizuar të gjitha ato, për të vazhduar me mundësinë për ta zbatuar ligjin në tërësi.

Por, duket se ligji i ri për kundërvajtje në kuadër të ndryshimeve të parapara ka bërë që të krijohet një gjendje jo e mirë në aspektin e ekzekutimit të gjobave. Me këtë ligj është hequr dënimi me burgim dhe mundësia e zëvendësimit të gjobës me një dënim të tillë.

IKD ka analizuar të dhënat zyrtare të gjykatave themelore në vend dhe ka paraqitur grafikisht situatën e parashkrimeve të lëndëve kundërvajtëse për secilën gjykatë. Parashkrimi si fenomen

ka ndikim mjaft negativ, duke bërë që sistemi i drejtësisë në raport jo vetëm me shkelësit e ligjit, por edhe me institucionet e tjera shtetërore të dështojë. Në këtë drejtim, duket se ndikim ka edhe qasja e sistemit të drejtësisë ndaj lëndëve të kësaj natyre, marrë parasysh faktin se efikasiteti i punës së gjyqtarëve që trajtojnë lëndë të kësaj natyre nuk do të duhej të shkonte duke u ulur por në drejtim të kundërt.

Çdo vit, Policia e Kosovës, inspektoratet qendrore e komunale, si dhe institucione të tjera që kanë autorizime të tilla, mundohen që përmes punës së tyre t'i ndëshkojnë kryerësit e kundërvajtjeve. Për këto punë, nga buxheti i shtetit ndahen shuma të caktuara parash me të vetmin qëllim që puna e tyre të kryhet pa probleme dhe të jenë sa më efikas. Por e gjitha dështon kur vjen radha e hallkës së gjyqësorit. Mos zgjidhja e rasteve, neglizhenca, ndryshimet ligjore dhe forma të tjera që çojnë në parashkrimin e këtyre lëndëve bëjnë që shkelësit e ligjit të ndihen më të fuqishëm, ndërsa institucionet e tjera të pafuqishëm kundrejt tyre, e ata që e respektojnë ligjin të ndihen, fatkeqësisht, të parëndësishëm.

Në këtë raport tregohet se numri i madh i lëndëve të parashkruara dhe rënia e efikasitetit bëjnë që investimet dhe iniciativat e tjera shtetërore në drejtim të trajtimit të kundërvajtjeve të dështojnë tërësisht. Krahas kësaj, humbjet e shtetit nga parashkrimi i lëndëve kundërvajtëse përgjatë tri vitetve të fundit kalojnë shifrën prej 2 milion euro.

2. Metodologjia

IKD me qëllim që të përpilojë një raport sa më gjithëpërfshirës dhe analitik, në lidhje me trajtimin e lëndëve të kundërvajtjeve në gjykatat e Kosovës, ka përdorur metodologji të përzier të hulumtimit.

Në këtë raport IKD ka përdorur dokumente të ndryshme zyrtare përfshi legjislacionin primar dhe sekondar, raportet e KGJK-së, si dhe të dhënat e tjera të siguruar nga institucionet e tjera përmes kërkesave për qasje në dokumente publike. IKD njëkohësisht ka analizuar bazën ligjore dhe dokumentet e tjera relevante të cilat e trajtojnë çështjen e punës së gjyqtarëve në drejtim të lëndëve kundërvajtëse.

Hulumtimi përfshin trajtimin e lëndëve të kundërvajtjeve nga të gjitha gjykatat në Kosovë, përgjatë periudhës kohore tre vjeçare (2016 – 2018). Bazuar në të dhënat e KGJK – së për secilën gjykatë në vend është nxjerrë efikasiteti real i punës së gjykatave, duke llogaritur individualisht të dhënat për secilën gjykatë, duke marrë për bazë numrin e lëndëve të zgjidhura nga gjykata përkatëse dhe numrin e gjyqtarëve të asaj gjykate që kanë qenë të ngarkuar me lëndë të natyrës kundërvajtëse përgjatë vitit respektiv.

Po ashtu, duke marrë për bazë numrin e lëndëve në punë dhe numrin e lëndëve të pazgjidhura në fund të secilit vit është nxjerrë përqindja e numrit të lëndëve të pazgjidhura për vitin respektiv.

Numri i rasteve të parashkruara në gjykatat e vendit është paraqitur duke marrë për bazë të dhënat e pranuar nga KGJK, kurse numri i rasteve të parashkruara brenda një dite, në një gjykatë respektive është arritur duke marrë për bazë numrin e lëndëve të parashkruara gjatë një viti dhe numrin e ditëve të punës gjatë atij viti.

Të dhënat e siguruar nga IKD mbi shqiptimin e gjobave në rastet e caktuara nga Gjykata Themelore në Prishtinë, janë shfrytëzuar në mënyrë që të bëhet llogaritja e humbjeve të përgjithshme që i janë shkaktuar buxhetit të shtetit si rrjedhojë e parashkrimit të lëndëve. Kështu, fillimisht është analizuar sa raste janë trajtuar gjithsej brenda vitit, pastaj në sa prej atyre rasteve janë shqiptuar gjoba dhe është nxjerrë përqindja lidhur me këtë. Pastaj është marrë numri i lëndëve të parashkruara gjatë atij viti dhe bazuar në përqindjen paraprake është nxjerrë numri i rasteve në të cilat do të shqiptoheshin gjobë po të mos arrihej parashkrimi i tyre. Njëkohësisht, nga vlera totale të hyrave të inkasuara si rrjedhojë e shqiptimit të gjobave dhe numri i gjobave të shqiptuara është nxjerrë mesatarja e një gjobe të shqiptuar brenda vitit respektiv. E krejt në fund, kjo shumë mesatare e gjobës është llogaritur në kuadër të numrit të gjobave që do të duhej të shqiptoheshin nëse lëndët nuk do të parashkruheshin dhe në këtë mënyrë kemi ardhur deri tek gjetja e vlerës të cilën e ka humbur buxheti i shtetit brenda një viti, për shkak të parashkrimit të lëndëve.

Të gjitha këto kanë mundësuar që IKD të identifikojë dhe trajtojë çështjet kryesore si dhe të propozojë rekomandime konkrete drejt zgjidhjes së problematikave në trajtimin e lëndëve të kundërvajtëse.

3. Mandati ligjor në ndjekje dhe gjykim të kundërvajtësve

Kundërvajtja përbën një sjellje, përmes së cilës shkelet ose rrezikohet rendi dhe qetësia publike, si dhe vlerat shoqërore të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, mbrojtja e të cilave nuk është e mundur pa sanksionimin kundërvajtës.¹

Në këtë drejtim, Kosova në vitin 2017 ka shënuar një pikë ndryshimi sa i përket fushës së kundërvajtjeve. Kjo sepse, në janar të atij viti ka hyrë në fuqi Ligji nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, i miratuar paraprakisht më 5 gusht 2016 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ky ligj u pa me sy të ndryshëm dhe hasi në kritika pozitive e negative edhe pasi filloi të zbatohet në praktikë.

Është fakt se para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, të gjitha shkeljet e natyrës kundërvajtëse ishin trajtuar sipas ligjit nr. 011/15-79 të Krahinës Autonome të Kosovës mbi Kundërvajtjet. Për individë të caktuar miratimi i këtij ligji, përbënte një hap pozitiv drejt avancimit të legjislacionit pozitiv të vendit tonë, meqë konsideronin se një ligj i vitit 1979 nuk përkonte me zhvillimin aktual të vendit dhe shoqërisë tonë. Në anën tjetër, Avokati i Popullit ishte një nga ata që shumë zëshëm e kishte kundërshtuar ligjin e ri, apo thënë më mirë disa nga dispozitat që dilnin nga ky ligj, meqë sipas këtij institucioni, këto dispozita ishin antikushtetuese dhe shkelin të drejtat e njeriut.

Avokati i Popullit mbikëqyr, promovon dhe mbron të drejtat dhe liritë themelore të personave fizikë dhe juridikë, nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, institucioneve dhe personave apo autoriteteve të tjera, të cilët ushtrojnë autorizime publike në Republikën e Kosovës.²

Andaj, më 10 shkurt 2017, ky institucion përmes një kërkesë iu drejtua Gjykatës Kushtetuese, duke kërkuar (1) shfuqizimin e nenit 55, paragrafët 4 – 5 dhe nenet 56 – 68 të ligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, si dhe (2) masë të përkohshme për pezullimin e menjëhershëm të këtyre dispozitave, deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese.³

Avokati i Popullit kontestonte dispozitat e Ligjit të ri për Kundërvajtje, të cilat “delegojnë kompetenca gjyqësore në ekzekutiv”, përkatësisht nenet 55 (paragrafët 4 dhe 5), 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67 dhe 68, duke pretenduar se të njëjtat nuk janë në përputhje me

¹ Ligji nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, neni 2.

² Fletushkë Informative e Avokatit të Popullit (Shih linkun <https://oik-rks.org/2018/11/01/misioni-kompetencat-dhe-pergjegjesite-e-institucionit-te-avokatit-te-popullit/>)

³ Avokati i Popullit. “Raport Vjetor 2017”. Prishtinë, 2018. Fq. 195

nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 [E Drejta për Gjykim të Drejtë] të KEDNJ – së.⁴

Kështu, Gjykata Kushtetuese me Vendimin VPM 1043/17, të datës 21 shkurt 2017, vendosi që ta miratojë masën e përkohshme në kohëzgjatje deri më 30 prill 2017 dhe të pezullojë menjëherë zbatimin e neneve 55 (paragrafët 4 dhe 5), 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67 dhe 68 të Ligjit për Kundërvajtje.⁵ Pastaj, kjo gjykatë, edhe një herë para se të merrte aktgjykimin sipas kërkesës së Avokatit të Popullit, mori vendim për vazhdimin e masave të përkohshme. Më 11 prill 2017, me vendimin nr. VVMP 1054/17, Kushtetuesja vendosi që t'i vazhdojë masat e përkohshme deri më 15 qershor 2017 dhe ta vazhdojë pezullimin e zbatimit të neneve 55 (paragrafët 4 dhe 5), 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67 dhe 68 të Ligjit për Kundërvajtje.⁶

Kurse, më 29 maj 2017, Kushtetuesja vendosi përfundimisht lidhur me kërkesën e Avokatit të Popullit. Kështu, Gjykata Kushtetuese, përmes aktgjykimit 1073/17, konstatoi se nenet 55 (paragrafët 4 dhe 5), 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67 dhe 68 të Ligjit për Kundërvajtje janë në përputhje me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ – së. Po ashtu kjo Gjykatë konstatoi që vendimi VPM 1054/17, me të cilin u vazhdua pezullimi i zbatimit të neneve të lartcekura deri më 15 qershor 2017, përfundon me hyrjen në fuqi të këtij Aktgjykimi.⁷

Kritikat dhe skepticizmi lidhur me këtë ligj u përmyllën me këtë aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese dhe tashmë krahas Gjykatës, për disa kundërvajtje (më të lehta) të përcaktuara me ligj apo rregullore të Kuvendit të Komunës, procedura e kundërvajtjes mund të zhvillohet, dhe sanksionin kundërvajtës mund ta shqiptojë organi i administratës shtetërore ose organi i cili kryen autorizime publike të mbikëqyrjes për zbatimin e ligjit, në të cilin janë paraparë kundërvajtje.⁸

Me këtë ligj, i është mundësuar gjykatave që të jenë më pak të ngarkuara, por në anën tjetër edhe është bërë e mundur që të shpejtohet procedura, meqë organet kompetente administrative kanë kompetenca për zhvillimin e procedurës kundërvajtëse. Kjo kompetencë i njihet për gjjobat fikse, gjjobat deri në 500 euro për personat fizik, deri në 1000 euro për personat juridik, si dhe për gjjobat e shqiptuara në vend.⁹

Në këtë drejtim, edhe vetë gjykatat e vendit e kanë parë këtë si një lehtësim dhe kanë dhënë vlerësime pozitive sa i përket ndikimit që ka pasur ligji i ri në këtë aspekt.

⁴ Gjykata Kushtetuese. "Aktgjykim në rastin KO12/17, nr. ref: AGJ 1073/17". Prishtinë. 29 maj 2017. Fq. 4

⁵ Gjykata Kushtetuese. "Vendim për masë të përkohshme, nr. ref: VPM 1043/17". Prishtinë. 21 shkurt 2017. Fq. 8

⁶ Gjykata Kushtetuese. "Vendim për vazhdimin e masave të përkohshme, nr. ref: VVPM 1054/17". Prishtinë. 11 prill 2017. Fq. 4

⁷ Gjykata Kushtetuese. "Aktgjykim në rastin KO12/17, nr. ref: AGJ 1073/17". Prishtinë. 29 maj 2017. Fq. 19

⁸ Ligji nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, neni 55.

⁹ Po aty, neni 56.

“LMK nr. 05/L-087, me të cilin përcaktohet kompetenca e organit kundërvajtës e që u janë dhënë autorizime shtesë për kundërvajtje të lehta sigurisht që ka efekt në punën e gjyqtarëve në aspektin pozitiv.”¹⁰

“Sigurisht se ka pasur efekt në punën e gjyqtarëve për kundërvajtje ligji i ri për Kundërvajtje me autorizimet shtesë që u janë dhënë Organeve Administrative.”¹¹

“Ka pasur efekt të madh në numrin e lëndëve, pasi që numri i lëndëve të ardhura nga Gjykatë, tash shumë më i vogël, nga vitet e mëhershme dhe kjo ka bërë që gjyqtarët të jenë më pak të ngarkuar me lëndë.”¹²

“Autorizimet shtesë për organet administrative kanë ndikuar pozitivisht në punën e gjykatës, sipas numrit të lëndëve të pranuar vërehet se është numër më i vogël i lëndëve që pranohen në gjykatë ku flet paraqitësit janë organet administrative.”¹³

Edhe situata në terren e vërteton një gjendje të tillë, ku sidomos gjatë vitit 2018 është rritur numri i gjobave të shqiptuara për shkelësit e Ligjit të Kontrollit të Duhanit, si dhe ndotësve të mjedisit. Tremujori i fundit i vitit 2018 shënon një kthesë në aspektin e trajtimit të rasteve të ndotjes së mjedisit. Shqiptimi i gjobave në këto raste gjen mbështetje në Udhëzimin Administrativ për Gjoha Mandatore, të nxjerrë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në tetor të vitit 2018, me qëllim të parandalimit të hedhjes së mbeturinave jashtë vendeve të caktuara për hedhjen e mbeturinave, eliminimin apo reduktimin e ndotjes, mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut, mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut, mbrojtjen e sipërfaqeve publike dhe private nga ndotja, përmes menaxhimit të mbeturinave. Njëkohësisht, ky UA bën përcaktimin e procedurave për shqiptimin e ndëshkimit me gjoba mandatore personave fizik dhe juridik, të cilët hedhin mbeturina jashtë vendeve të caktuara për hedhjen e mbeturinave.¹⁴

Për dallim prej gjobave të shqiptuara ndaj ndotësve të mjedisit, për ata që nuk respektojnë ligjin për duhanin gjendja nuk qëndron shumë mirë. Përkundër faktit se Ligji i ri mbi kontrollin e duhanit¹⁵ kishte hyrë në fuqi qysh në vitin 2013, ky ligj asnjëherë nuk gjeti zbatim në nivelin e duhur. Bazuar në këtë ligj është rreptësisht e ndaluar pirja e duhanit në ambiente të mbyllura, në të kundërtën, parashihet shqiptimi i gjobave të ndryshme ndaj shkelësve të këtij ligji.

Edhe përkundër faktit se ligjet kanë paraparë të gjitha këto çështje, megjithatë problemi kryesor vazhdon të mbetet implementimi i tyre në praktikë, efikasiteti i punës së gjykatave në nivel vendi, e mbi të gjitha ekzekutimi i gjobave.

¹⁰ Intervistë me Gjyqtarin Mbikëqyrës të Divizionit për Kundërvajtje në Gjykatën Themelore në Prishtinë, z. Mustafë Selimi. 28 shkurt, 2019.

¹¹ Intervistë me Kryesuesin e Divizionit për Kundërvajtje në Gjykatën Themelore në Pejë, z. Kadri Prekaj. 6 mars, 2019.

¹² Intervistë me Kryetarin e Gjykatës Themelore në Gjiilan, z. Ramiz Azizi. 5 mars, 2019.

¹³ Intervistë me Kryetarin e Gjykatës Themelore të Gjakovës, z. Vatun Durguti. 12 mars, 2019.

¹⁴ Udhëzim Administrativ MMPH – Nr. 06/2018 për Ndëshkimet me Gjoha Mandatore, neni 1.

¹⁵ Ligji nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit.

Në drejtim të ekzekutimit të gjobave, ligji i ri për kundërvajtje më nuk e parasheh dënimin me burgim dhe mundësinë e zëvendësimit të gjobës me dënim me burg. Kjo vjen si rrjedhojë e faktit se diçka e tillë është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Një fenomen i tillë, i mbajtjes së burgimit për shkak të kundërvajtjeve ishte identifikuar shpesh para hyrjes në fuqi të ligjit të ri. Por, një gjë e tillë, përkundër ndryshimeve në ligjin për kundërvajtje, ende sot parashihet me Ligjin nr. 03/L-142 për Rendin dhe Qetësinë Publike. Në dispozitat ku përshkruhen kundërvajtjet kundër rendit dhe qetësisë publike, po ashtu janë paraparë sanksionet për të njëjtat, tek të cilat parashihet edhe dënimi me burgim. Si rrjedhojë, mund të themi se ky ligj është në kundërshtim me atë të kundërvajtjeve dhe Kushtetutën e vendit.

4. Analizë përshkruese e inicimit të procedurave kundërvajtëse në Gjykatat Themelore nga institucionet kompetente

Në bazë të hulumtimit të realizuar nga IKD dhe bazuar në korrespondencën e zhvilluar me zyrtarët për informim të Gjykatave Themelore në Republikën e Kosovës, rezulton se institucioni i cili më së shpeshti inicion procedura të natyrës kundërvajtëse në gjykatat e vendit është Policia e Kosovës.

Krahas Policisë, gjoba shqiptojnë edhe Inspektoratet Qendrore në kuadër të Ministrive Përkatëse, si dhe Drejtoritë Komunale.

Pas inicimit të procedurës nga organi kompetent, barra e të provuarit të kundërvajtjes dhe të përgjegjësishë së kundërvajtjes është në paraqitësin e kërkesës për fillimin e procedurës së kundërvajtjes.¹⁶

Para se të merret vendimi për kundërvajtjen, të pandehurit do t'i jepet mundësia që të deklarohet lidhur me faktin çka i vihet në barrë.¹⁷ Nëse i pandehuri i thirrur në mënyrë të rregullt nuk paraqitet që të merret në pyetje dhe nuk e arsyeton mungesën, kurse marrja e tij në pyetje nuk është e domosdoshme për konstatimin e fakteve të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, vendimi për kundërvajtjen mund të merret edhe pa marrjen në pyetje të të pandehurit.¹⁸

Procedura e kundërvajtjes zhvillohet në mënyrë të shpejtë dhe të shkurtër, por kjo të mos jetë në dëm të vendimit të drejtë dhe të ligjshëm.¹⁹ Askush përsëri nuk mund të gjykohet për kundërvajtje për të cilën me vendimin e formës së prerë është gjykuar apo liruar.²⁰

¹⁶ Ligji nr. 05/L-087 për Kundërvajtje. Neni 47.

¹⁷ Po aty. Neni 48, par. 1.

¹⁸ Po aty, par. 2.

¹⁹ Po aty. Neni 50.

²⁰ Po aty. Neni 52.

Ndërsa, kundër vendimit të nxjerrë në shkallën e parë mund të paraqitet ankesa, nëse me ligj nuk është caktuar ndryshe.²¹

Ndërsa me ligjin e ri, si risi shihet çështja se organi kundërvajtës zhvillon procedurën e kundërvajtjes, nëse me ligj është paraparë kompetenca ekskluzive për veprimin e saj.²² Organi i kundërvajtjes e zhvillon procedurën e kundërvajtjes sipas detyrës zyrtare, me kërkesën e personit zyrtar të autorizuar ose me kërkesë të organit të autorizuar, apo me kërkesë të të dëmtuarit.²³

4.1. Policia e Kosovës

Bazuar në përgjigjet e marra nga gjykatat e vendit rezulton se Policia e Kosovës është një nga institucionet që më së shpeshti inicion procedura të kundërvajtjeve në këto gjykata.

Policia e Kosovës gjatë vitit 2018, kishte themeluar “task forcën” për parandalimin e aksidenteve në trafikun rrugor, me qëllim të ngritjes së nivelit të sigurisë, parandalimin e aksidenteve të trafikut dhe zbatimin e ligjshmërisë në funksion të menaxhimit dhe kontrollit të trafikut rrugor.²⁴

Krahas kësaj, sipas të dhënave nga Policia e Kosovës, vetëm gjatë periudhës Janar-Nëntor të vitit 2018 kanë ndodhur 14 mijë e 393 aksidente, prej të cilave 85 kanë qenë me fatalitet, ku kanë humbur jetën 110 persona. Ndërsa, 5 mijë e 706 aksidente kanë qenë me të lënduar, nga ku 11 mijë e 336 persona kanë pësuar lëndime trupore, ndërsa aksidente me dëme materiale janë shënuar 8 mijë e 602 sosh. Ndryshe, brengë e vazhdueshme e shoqërisë kosovare si dhe e sistemit të drejtësisë në vend, mbetet po ashtu edhe numri i madh i lëndëve nëpër gjykata.²⁵

Andaj, lidhur me trajtimin e këtyre rasteve në gjykata IKD ka komunikuar me PK në mënyrë që të krijojë një pasqyrë më të qartë lidhur me këtë situatë. Në përgjigjen e saj për IKD, PK, ka konfirmuar se vetëm gjatë vitit 2018 ka proceduar në gjykata 10,904 raste të kundërvajtjes. Nga këto, sipas tyre, prijnë rastet e iniciuara për aksidentet në trafik me dëme materiale dhe ato për prishje të rendit dhe qetësisë publike.²⁶

Megjithatë, PK e kishte të pamundur të na informojë saktësisht mbi numrin e rasteve veç e veç për secilën gjykatë, apo edhe veçanërisht për natyrën e rastit konkret.

Andaj, ne kemi kërkuar nga ky institucion të na dërgojë të dhëna edhe mbi numrin e gjobave të shqiptuara përgjatë viteve 2016, 2017 dhe 2018, në mënyrë që të bëhet një krahasim i të dhënave

²¹ Po aty. Neni 54.

²² Po aty. Neni 56.


²³ Po aty. Neni 61.

²⁴ *Numri i aksidenteve në trafik në rritje, dënimet ndaj të akuzuarve me rënie*. Betimi për Drejtësi. 3 Janar, 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/numri-i-aksidenteve-ne-trafik-ne-rritje-denimet-ndaj-te-akuzuarve-me-renie/>)

²⁵ Po aty.

²⁶ Komunikim përmes postës elektronike me Zyrën për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun të Policisë së Kosovës. 22 janar, 2019.

të tilla. Nga përgjigja e tyre rezulton se në vitin 2018 është shqiptuar numri më i madh i gjobave për kundërvajtje në trafikun rrugor. (shih tabelën më poshtë)



Grafikoni 1 – Numri i gjobave të shqiptuara nga Policia e Kosovës për kundërvajtje në trafikun rrugor (2016, 2017 dhe 2018)²⁷

Nga 400,095 gjoba për kundërvajtje në trafikun rrugor të shqiptura gjatë vitit 2018, PK ka njoftuar se 96.5% e tyre janë gjoba mandatore. Nga këto, të paguara janë 61.30%, të papaguara janë 38.70%, ndërsa 3.5% janë proceduar në gjykatë. (shih grafikun më poshtë)



Grafikoni 2 – Gjendja e gjobave të shqiptuara nga Policia e Kosovës gjatë vitit 2018²⁸

²⁷ Komunikim përmes postës elektronike me Zyrën për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun të Policisë së Kosovës. 01 shkurt, 2019.

Prej këtyre gjobave të shqiptuara, PK ka njoftuar se gjatë vitit 2018 janë arkëtuar 8,427,711.59 euro. Kjo shumë është 140% më shumë sesa vlera e arkëtuar në vitin 2017.²⁹ Ndërsa sa i përket parashkrimit të tyre, sipas përgjigjes së PK, kjo është në kompetencë të gjykatave përkatëse dhe rrjedhimisht nuk kanë informacione më të detajuara për këtë çështje.

4.2. Inspektorët qendrorë dhe komunalë

Përveç Policisë së Kosovës, autorizime për shqiptimin e gjobave kanë edhe inspektorët e inspektorateve të ndryshme qendrore dhe komunale. Në këtë aspekt, bazuar në hulumtimin e realizuar nga IKD, rezulton se këto inspektorate kanë shqiptuar numrin më të madh të gjobave kundër ndotësve të mjedisit dhe shkelësve të Ligjit për Kontrollin e Duhanit.

4.2.1. Gjobat kundër ndotësve të mjedisit

Gjatë viteve të fundit edhe Kosova është përfshirë në kuadër të vendeve të botës që kanë intensifikuar përpjekjet që të kenë një ambient sa më të pastër. Në këtë drejtim Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe organizata “Let’s Do It Kosova”, kishin zhvilluar projektin “Ta pastrojmë Kosovën”.

Let’s Do It, është organizatë e cila merret me ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit në Kosovë, organizimin e qytetarëve për adresimin e problemeve, pjesëmarrjen e tyre nëpër aktivitete të ndryshme si (aksione të pastrimit, fushata vetëdijësuese dhe aktivitete të tjera vullnetare).³⁰ Përveç këtyre, kjo organizatë ka bërë edhe monitorimin e zbatimit të Udhëzimit Administrativ për Gjoha Mandatore nga inspektorët mjedisor.

Ky Udhëzim është nxjerrë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në tetor të vitit 2018, me qëllim të parandalimit të hedhjes së mbeturinave jashtë vendeve të caktuara për hedhjen e mbeturinave, eliminimin apo reduktimin e ndotjes, mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut, mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut, mbrojtjen e sipërfaqeve publike dhe private nga ndotja, përmes menaxhimit të mbeturinave.³¹

Njëkohësisht, ku UA bën përcaktimin e procedurave për shqiptimin e ndëshkimit me gjoja mandatore personave fizik dhe juridik, të cilët hedhin mbeturina jashtë vendeve të caktuara për hedhjen e mbeturinave.³²

²⁸ Po aty.

²⁹ “Shqetësues numri aksidenteve me fatalitet, vitin e kaluar janë arkëtuar rreth 8.5 milionë euro nga shqiptimi gjobave në trafik”. Telegrafi.com. E qasshme së fundi më 17 mars, 2019. (Shih linkun: <https://telegrafi.com/shqetesues-numri-aksidenteve-fatalitet-vitin-e-kaluar-jane-arketuar-rreth-8-5-milione-euro-nga-shqiptimi-gjobave-ne-trafik/>)

³⁰ *Kush jemi ne?*. Let’s Do It Kosova. 22 janar, 2019. (Shih linkun: <https://www.letsdoitkosova.org/>)

³¹ Udhëzim Administrativ MMPH – Nr. 06/2018 për Ndëshkimet me Gjoha Mandatore. Neni 1.

³² Po aty.

Në bazë të monitorimit të realizuar nga organizata “Let’s Do it Kosova”, rezulton se gjatë muajit nëntor të vitit 2018, në të gjitha komunat e Kosovës janë shqiptuar 89 gjoba mandatore për ndotësit. Komuna e Prishtinës i prin listës së komunave me më së shumti gjoba të shqiptuara, gjithsej 35, pasuar nga Komuna e Vushtrrisë ku janë shqiptuar nëntë gjoba nga inspektorët mjedisor. Me nga shtatë gjoba të shqiptuara lista vazhdon me Komunën e Gjakovës dhe atë të Malishevës, pasuar nga Komuna e Prizrenit me pesë gjoba të shqiptuara për ndotësit, derisa në Komunën e Pejës, të Istogut dhe atë të Obiliqit janë shqiptuara nga katër gjoba për ndotje të mjedisit. Në Komunën e Vitisë janë shqiptuar vetëm dy gjoba gjatë muajit nëntor, ndërsa tri të tilla kanë qenë në Komunën e Kamenicës. Por, asnjë gjobë e vetme nuk është shqiptuar në komunat, si: Rahoveci, Fushë Kosova, Skenderaj, Podujeva, Mitrovica, Ferizaj, Kaçanik, Hani i Elezit, Klina, Deçani, Juniku, Shtimja, Lipjani, Drenasi dhe Dragashi. Përderisa, në Komunën e Gjilanit dhe atë të Suharekës është shqiptuar vetëm nga një gjobë për ndotësit.³³

Ndërsa, bazuar në të dhënat e monitorimit të muajit dhjetor 2018, rezulton se në të gjitha komunat e Kosovës janë shqiptuar 84 gjoba mandatore për ndotësit. Edhe në muajin dhjetor, ngjashëm si në nëntor, Komuna e Prishtinës vazhdon t’i prijë listës së komunave me më së shumti gjoba të shqiptuara, gjithsej 25, pasuar nga Komuna e Mitrovicës dhe Junikut, në të cilat janë shqiptuar 10 gjoba nga inspektorët mjedisor. Lista e komunave vazhdon me Pejën, ku janë shpërndarë 6 gjoba për ndotësit, dhe Prizrenin ku janë shqiptuar 4 gjoba. Me nga 3 gjoba të shqiptuara janë Komuna e Vushtrrisë, Malishevës, Deçanit, Rahovecit dhe Gjilanit. Në Komunën e Lipjanit dhe atë të Drenasit janë shqiptuar vetëm nga dy gjoba për ndotësit, ndërsa në Komunat, si: Suharekë, Shtime, Istog, Gjakovë dhe Obiliq janë shqiptuar vetëm nga 1 gjobë për ndotësit. Por, asnjë gjobë e vetme nuk është shqiptuar në komunat, si: Fushë Kosovë, Skenderaj, Podujevë, Viti, Kamenicë, Kaçanik, Hani i Elezit dhe Klinë.³⁴

Edhe nëntori edhe dhjetori karakterizohen me llojin e njëjtë të gjobave, si lloji më i shpeshtë i shqiptuar – ai për hedhjen e mbeturinave dhe materialeve ndërtimore jashtë vendeve të caktuara. Gjatë monitorimit, të kryer nga Ekipi i Let’s Do It, rezulton se sikur gjatë nëntorit edhe gjatë dhjetorit, sfidë për zbatimin e Udhëzimit Administrativ për Gjoba Mandatore vazhdon të mbetet mos pajisja e Policisë së Kosovës me tiketa të gjobave mandatore si dhe mungesa e inspektorëve mjedisor në disa prej komunave.^{35 36}

Në punëtorinë “Politikat mjedisore dhe sfidat në zbatimin e tyre”, përfaqësues të organizatës “Let’s Do It Kosova”, kanë thënë se barra kryesore e zbatimit të UA nr. 06/2018 bie mbi

³³ 89 gjoba për ndotësit vetëm gjatë muajit nëntor. Let’s Do It Kosova. 22 janar, 2019. (Shih linkun: <https://www.letsdoitkosova.org/89-gjoba-per-ndotesit-vetem-gjate-muajit-nentor/>)

³⁴ 84 gjoba për ndotësit e mjedisit gjatë muajit dhjetor. Let’s Do It Kosova. 22 janar, 2019. (Shih linkun: <https://www.letsdoitkosova.org/84-gjoba-per-ndotesit-e-mjedisit-gjate-muajit-dhjetor/>)

³⁵ 89 gjoba për ndotësit vetëm gjatë muajit nëntor. Let’s Do It Kosova. 22 janar, 2019. (Shih linkun: <https://www.letsdoitkosova.org/89-gjoba-per-ndotesit-vetem-gjate-muajit-nentor/>)

³⁶ 84 gjoba për ndotësit e mjedisit gjatë muajit dhjetor. Let’s Do It Kosova. 22 janar, 2019. (Shih linkun: <https://www.letsdoitkosova.org/84-gjoba-per-ndotesit-e-mjedisit-gjate-muajit-dhjetor/>)

inspektoratin. E po ashtu është cekur se deri më tani janë shqiptuar 300 gjoba mandatore nga inspektorati kundër atyre që e ndotën ambientin.³⁷

Lidhur me problemet në trajtimin e lëndëve të kësaj natyre, e mbi të gjitha mbi arsyet e zvarritjes së lëndëve mjedisore në Prokurori dhe Gjykata ishte diskutuar edhe në tryezën e mbajtur më 22 nëntor në Prishtinë, të titulluar “Parandalimi dhe luftimi i problemeve të mjedisit”, e organizuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit dhe Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD).

Avokati i Popullit z. Hilmi Jashari, theksoi para të pranishmëve se gjendja e mjedisit është duke prekur nenin 2, të Konventës Evropiane, e Drejta e jetës, përderisa vonesat në marrjen e vendimeve lidhur me këto raste prekin nenin 6, E drejta për një proces të rregullt, të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, dhe neni 13, e Drejta për zgjidhje efektive. Avokati i Popullit, deklaroi se është obligim pozitiv i shtetit që qytetarëve t’u garantoj të drejtat e njeriut. Kurse, sipas drejtorit të IKD-së, Z. Ehat Miftaraj, prokurorët dhe gjykatësit duhet të trajnohen në këtë lëmi.³⁸

Prokuroria e shtetit, njoftoi se përkundër që mjedisi është çështje me shumë rëndësi, sistemi prokurorial nuk ka statistika lidhur me këto raste dhe se krimet mjedisore zakonisht lidhen me rastet që kanë të bëjnë me keqpërdorimin e detyrës zyrtare. Ndërsa edhe nga Gjykata Themelore në Prishtinë u bë e ditur se ende nuk ka statistika lidhur me lëndët e kësaj natyre, por që numri i rasteve të kësaj natyre është i vogël.³⁹

Nga diskutimet në këtë tryezë u kuptua se nuk ka statistika lidhur me këto raste në prokurori dhe gjykata, ka zvarritje të këtyre rasteve dhe se këto çështje nuk hyjnë në prioritetet e sistemit prokurorial dhe gjyqësor.⁴⁰

4.2.2. Gjobat kundër shkelësve të Ligjit për Kontrollin e Duhanit

Ligji mbi kontrollin e duhanit kishte hyrë në fuqi qysh në vitin 2013. Bazuar në këtë ligj është rreptësisht e ndaluar pirja e duhanit në ambiente të mbyllura, në të kundërtën, shqiptohen gjoba të ndryshme ndaj shkelësve të këtij ligji.

Megjithatë, edhe pas plot 6 vjetësh nga hyrja në fuqi e këtij ligji, vendi jonë mbetet vazhdimisht i sfiduar nga shkelësit e tij. Madje, gjendja e tillë është vërtetuar edhe nga Inspektorati Sanitar i Kosovës. Sipas shefit të këtij Inspektorati, Ibrahim Tershnjaku, janë disa faktorë që po e pamundësojnë zbatimin e ligjit, mbi të gjitha ai thekson mos shqiptimin e gjobave nga gjykatat.

³⁷ Deri më tani janë shqiptuar 300 gjoba ndaj atyre që ndotën ambientin. Gazeta Express. 22 janar, 2019. (Shih linkun <https://www.gazetaexpress.com/lajme/deri-me-tani-jan300-gjoba-ndaj-atyre-qe-ndoten-ambientin-618451/>).

³⁸ “Institucioni i Avokatit të Popullit dhe Instituti i Kosovës për Drejtësi, organizoi tryezën “Parandalimi dhe luftimi i problemeve të mjedisit”. 22 nëntor, 2018. (Shih linkun: <https://www.facebook.com/216051828531479/posts/institucioni-i-avokatit-t%C3%AB-popullit-dhe-instituti-i-kosov%C3%ABs-p%C3%ABr-drejt%C3%ABsi-organiz/1382336171903033/>)

³⁹ Po aty.

⁴⁰ Po aty.

“Marrja e gjobës ka qenë shumë e vonuar ose hiç fare nuk është shqiptuar nga ana e gjykatës. Dhe ky fenomen i shfaqur në çështjen e zbatueshmërisë së ligjit po merr përmasa të tjera, ndoshta edhe të mendimit të asaj se si të bëhet plotësim-ndryshimi i këtij ligji”, kishte thënë Tershnjaku.⁴¹

Sipas tij, problem tjetër është edhe mos zbatimi i ligjit nga kryetarët e komunave. Ai thotë se e vetmja komunë që ka vullnet ta luftojë këtë dukuri është Komuna e Drenasit.⁴²

Kjo çështje, në vend se me kalimin e kohës të ketë sa më pak probleme, në realitet me kalimin e viteve vetëm sa po përballet me më shumë pengesa.

Nga rezultatet e monitorimeve të Qendrës Kosovare për Avokim dhe Zhvillim (KADC), rezulton shkelësit më të mëdhenj të ligjit janë klubet e natës, të cilat e shkelin ligjin pa përjashtim me 100%, pastaj vijnë kafenetë me 78% dhe restorantet me 60%.⁴³

Edhe zyrtarët nga kjo organizatë e shohin si një nga faktorët kryesorë të mos zbatimit të ligjit faktin që gjykatat nuk i trajtojnë lëndët e kësaj natyre siç duhet. Sipas KADC, inspektorati sanitar ndjen se autoriteti i tyre është dëmtuar për shkak të vonesave në trajtimin e lëndëve që zgjasin deri në dy e tre vjet, për shkak të zvogëlimit të gjobave deri në shumën të parëndësishme të të hollave, si dhe hedhjes së rasteve nën justifikimin e mungesës së provave.⁴⁴

Po ashtu, KADC thekson se një fakt tjetër me rëndësi është që nuk janë ndëshkuar shkelësit recidivë edhe pse dihen se cilët janë, gjë që ka çuar mesazhin e gabuar se shkelja e ligjit nuk ndëshkohet dhe madje ka kontribuar në rritjen e konkurrencës jo – lojale.⁴⁵

Ndërsa, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë ka njoftuar se gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2018 janë kryer 66 kontrole zyrtare gjatë orarit zyrtar të punës. Aty ku janë hasur shkelës të ligjit janë penalizuar dhe janë iniciuar 12 fletëparaqitje të cilat janë dërguar në gjykata kompetente.⁴⁶

Megjithatë, edhe përkundër kontrolleve dhe disa gjobave të shqiptuara, në realitet situata faktike është në gjendje aspak të mirë. Andaj, puna e organeve administrative kundrejt kontrolleve dhe shqiptimit të gjobave duhet të jetë më e rreptë dhe efektive, sepse në të kundërtën nuk ka përmirësime dhe as respektim të ligjit.

⁴¹ *Ligji për kontrollin e duhanit nuk po zbatohet.* Koha.net. 22 janar, 2019. (Shih linkun: <https://www.koha.net/arberi/119223/ligji-per-kontrollin-e-duhanit-nuk-po-zbatohet/>).

⁴² Po aty.

⁴³ *Skandaloze/Duhani pushton lokalet anembanë Kosovës.* Syri.net. 22 janar, 2019. (Shih linkun: https://www.syri.net/syri_kosova/sociale-lajme/4679/skandalozeose-duhani-pushton-lokalet-anembane-kosoves/).

⁴⁴ Po aty.

⁴⁵ Po aty.

⁴⁶ Po aty.

5. Ngarkesa e Gjykatave me lëndë të kundërvajtjeve përgjatë viteve 2016, 2017 dhe 2018

Të dhënat në tabelën e mëposhtme janë të marra nga raportet vjetore të KGJK – së dhe pasqyrojnë numrin e përgjithshëm të lëndëve të kundërvajtjeve në gjitha gjykatat në vend.

Viti	Lëndë të pazgjidhura në fillim	Lëndë të pranuar në punë	Lëndë të zgjidhura	Lëndë të pazgjidhura në fund
2016	210,983	355,865	377,114	189,734
2017	189,734	135,023	219,554	105,203
2018	104,713	34,812	93,975	45,550

Tabela 1. Gjendja e lëndëve të kundërvajtjeve në Gjykatat Themelore të Republikës së Kosovës (2016, 2017 dhe 2018)^{47 48 49}

Ajo që bie në sy nga analiza e këtyre statistikave është fakti se në vitin 2018 ka një numër dukshëm më të vogël të lëndëve të pranuar në punë. Kjo tregon se Ligji i ri për Kundërvajtje me autorizimet që i ka dhënë edhe organeve administrative për shqiptimin e gjobave, ka bërë që numri i lëndëve të kësaj natyre në gjykatat e vendit, të zvogëlohet. Megjithatë, edhe përkundër këtij ndikimi, numri i lëndëve të zgjidhura ka shënuar shkallën më të ulët për tri vitet e fundit.

IKD ka analizuar të gjitha shifrat – pra lëndët e trashëguara nga viti paraprak, apo ndryshe siç njihen si lëndët e pazgjidhura në fillim të vitit, lëndët e reja të pranuar përgjatë atij viti, lëndët e pazgjidhura në fund dhe lëndët të cilat janë zgjidhur, e në këtë mënyrë ka ardhur deri tek rezultati konkret i punës së gjyqtarëve në të gjitha gjykatat themelore të vendit, të cilat pasqyrohen grafikisht në pjesën e dytë të këtij raporti.

Në pjesën e më poshtme të këtij raporti, këto të gjetura janë paraqitur edhe në formë grafike, në mënyrë që të pasqyrohet më qartë efikasiteti real i secilës gjykatë, si dhe trendi i lëndëve të pazgjidhura në fund të secilit vit. Po ashtu, IKD ka kërkuar nga KGJK – ja të dhënat lidhur me numrin e saktë të lëndëve kundërvajtëse të parashkuara në secilën gjykatë të vendit, përgjatë viteve 2016, 2017 dhe 2018 dhe më pas ka analizuar të gjitha këto të dhëna, për të paraqitur të gjeturat në vijim.

6. Parashkrimi i lëndëve të kundërvajtjeve në gjykatat themelore të Kosovës


⁴⁷ KGJK, “Raporti Statistikor i Gjykatave Vjetor 2016”. Prishtinë, 2017. Fq. 11.

⁴⁸ KGJK, “Raporti Statistikor i Gjykatave Vjetor 2017”. Prishtinë, 2018. Fq. 11.

⁴⁹ KGJK, “Raporti Statistikor i Gjykatave Vjetor 2018”. Prishtinë, 2019. Fq. 11.

Parashkrimi është një nga çështjet më shqetësuese të sistemit gjyqësor në Republikën e Kosovës, e sidomos në Divizionin e Kundërvajtjeve. Bazuar nga gjithë statistikat e paraqitura më sipër në këtë raport, shumë qartë shihet se numri i lëndëve që parashkruhen në gjykatat e vendit tregon një situatë aspak të mirë të gjykatave të vendit në këtë drejtim.

Bazuar në të dhënat e siguruara nga KGJK, IKD ka gjetur se në tri vitet e fundit ka pasur një numër të kosniderueshëm të lëndëve të parashkruara në të gjitha gjykatat e vendit. Në grafikonin në vijim, fillimisht kemi paraqitur vlerën totale të lëndëve të natyrës kundërvajtëse të parashkruara gjatë tri viteve të fundit në gjykatat e vendit (shih grafikonin e më poshtëm)




Grafikoni 3. Numri i përgjithshëm i lëndëve të kundërvajtjeve të parashkruara në total në të gjitha gjykatat e vendit⁵⁰

Në mënyrë që të vijë deri tek gjetjet konkrete mbi shkaktarët që kanë çuar në një numër të madh të lëndëve kundërvajtëse të parashkruara përgjatë tri viteve të fundit, në vijim të këtij raporti paraqitet edhe gjendja e lëndëve të kundërvajtjeve në secilën gjykatë dhe degë të Kosovës, bazuar në të dhënat e përgjithshme dhe pastaj analizimi i tyre për të konkretizuar rezultate dhe të gjetura specifike mbi efikasitetin dhe parashkrimin e këtyre lëndëve në këto gjykata.


6.1. Lëndët e kundërvajtjeve të pazgjidhura në fund të vitit në të gjitha gjykatat e vendit përgjatë viteve 2016, 2017 dhe 2018, të shprehura në përqindje (%)

⁵⁰ Korrespondenca përmes postës elektronike me Departamentin e Statistikës në KGJK. 15 Shkurt, 2019.

Për të paraqitur qartë numrin e lëndëve të pazgjidhura, IKD ka mbledhur numrin e lëndëve të pazgjidhura në fillim me numrin e lëndëve të pranuar po atë vit, përmes së cilave është fituar numri i lëndëve në punë⁵¹. Në raport me këtë numër është llogaritur sa lëndë kanë mbetur të pazgjidhura në fund dhe në këtë mënyrë për secilën periudhë kohore është shprehur në përqindje numri i lëndëve të pazgjidhura në fund të secilit vit respektiv. (shih tabelën e më poshtme)




Grafikoni 4. Lëndët e kundërvajtjeve të pazgjidhura në fund të vitit në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe degët e saj – Podujevë, Lipjan dhe Drenas (2016, 2017 dhe 2018), të shprehura në përqindje (%)




Grafikoni 5. Lëndët e kundërvajtjeve të pazgjidhura në fund të vitit në Gjykatën Themelore në Gjilan dhe degët e saj –Kamenicë, Viti dhe Novobërdë (2016, 2017 dhe 2018), të shprehura në përqindje (%)


⁵¹ Vërejtje: Të gjitha këto të dhëna janë marrë nga Raportet Vjetore të punës së Gjykatave, të publikuara nga KGJK (për vitin 2016, vitin 2017 dhe vitin 2018).




Grafikoni 6. Lëndët e kundërvajtjeve të pazgjdhura në fund të vitit në Gjykatën Themelore në Prizren dhe degët e saj – Dragash dhe Suharekë (2016, 2017 dhe 2018), të shprehura në përqindje (%)




Grafikoni 7. Lëndët e kundërvajtjeve të pazgjdhura në fund të vitit në Gjykatën Themelore në Mitrovicë dhe degët e saj – Vushtrri dhe Skenderaj (2016, 2017 dhe 2018), të shprehura në përqindje (%)



Grafikoni 8. Lëndët e kundërvajtjeve të pazgjdhura në fund të vitit në Gjykatën Themelore në Gjakovë dhe degët e saj – Malishevë dhe Rahovec (2016, 2017 dhe 2018), të shprehura në përqindje (%)



Grafikoni 9. Lëndët e kundërvajtjeve të pazgjidhura në fund të vitit në Gjykatën Themelore në Pejë dhe degët e saj –Istog, Klinë dhe Deçan (2016, 2017 dhe 2018), të shprehura në përqindje (%)



Grafikoni 10. Lëndët e kundërvajtjeve të pazgjidhura në fund të vitit në Gjykatën Themelore në Ferizaj dhe degët e saj – Kaçanik dhe Shtërpcë (2016, 2017 dhe 2018), të shprehura në përqindje (%)

6.2. Efikasiteti i gjykatave në trajtimin e lëndëve të kundërvajtjeve

Në bazë të raportit vjetor të publikuar nga KGJK, në pjesën ku trajtohet performanca e gjyqtarëve, janë përfshirë të gjitha gjykatat dhe degët e gjykatave themelore në Kosovë. Metoda e përdorur për llogaritjen e efikasitetit të gjykatës, bazuar në këtë raport, tregon rezultate mjaft pozitive, meqë ajo paraqet raportin në mes të lëndëve të zgjidhura dhe atyre të pranuar në punë gjatë atij viti. (shih tabelën më poshtë)

	Mesatarja e ngarkesës së gjyqtarit me lëndë të reja për një muaj	% Efikasiteti i gjykatës (lëndët e zgjidhura / lëndët e reja)	Mesatarja e lëndëve të zgjidhura për gjyqtar për një muaj	Lëndët e pazgjidhura		% (+) rritja ose (-) zvogëlimi në periudhën raportuese
				Në fillim të periudhës raportuese	Në fund të periudhës raportuese	
2016	587.2	106%	622.3	210,983	189,734	-10.07%
2017	967.9	163%	1573.9	189,734	105,203	-44.55%
2018	65.4	271%	177.2	104,713	46,352	-55.73%

Tabela 2. Ngarkesa e gjyqtarit me lëndë dhe mesatarja e lëndëve të zgjidhura për gjyqtar si dhe lëndët e pazgjidhura në fund në Gjykatat Themelore (2016, 2017, nëntë mujori i viti 2018)^{52 53 54}

Bazuar në raportet vjetore të KGJK – së, divizioni i kundërvajtjes gjithmonë e tejkalon 100% të efikasitetit, kjo për shkak të metodës që përdoret për llogaritjen e tij, sepse analizohet numri i lëndëve të pranuar dhe ai i lëndëve të zgjidhura në fund të çdo viti, nga i cili rezulton se gjyqtarët pothuajse çdo vit kryejnë më shumë lëndë sesa që pranojnë gjatë atij viti.

Por në kohën kur lëndët e pranuar në gjykatë shënojnë rënie, siç është rasti në vitin 2018, bashkë me to rënie shënon edhe numri i lëndëve të kryera nga një gjyqtar për një muaj. Kjo të bën të mendosh se punohet vetëm për tejkalimin e numrit të lëndëve të pranuar për atë vit, e jo në tërësi të vazhdojë zgjidhja e lëndëve me ritmin e njëjtë sikurse në vitet paraprake.


Rrjedhimisht në fund nuk zgjidhen mjaftueshëm lëndë dhe mbesin shumë sosh të pakryera nga ato që janë në punë.

Në këtë drejtim, IKD ka arritur të nxjerrë mesataren e numrit të lëndëve të zgjidhura nga një gjyqtar, gjatë një muaji, për secilin vit (2016, 2017 dhe 2018), në bazë të llogaritjeve individuale për gjykatën respektive, duke marrë për bazë numrin e lëndëve të zgjidhura nga gjykata përkatëse dhe numrin e gjyqtarëve të asaj gjykate që kanë qenë të ngarkuar me lëndë të kësaj natyre përgjatë vitit respektiv. Në këtë mënyrë konsiderojmë se është pasqyruar efikasiteti real i punës së gjyqtarëve të secilës gjykatë themelore dhe degë të saj në vend dhe njëkohësisht është pasqyruar qartë diskrepanca në aspektin sasior të punës së gjyqtarit nga viti në vit.


⁵² KGJK, “Raporti Statistikor i Gjykatave Vjetor 2016”. Prishtinë, 2017. Fq. 3.

⁵³ KGJK, “Raporti Statistikor i Gjykatave Vjetor 2017”. Prishtinë, 2018. Fq. 3.

⁵⁴ KGJK, “Raporti Statistikor i Gjykatave Vjetor 2018”. Prishtinë, 2019. Fq. 3.




Grafikoni 11. Mesatarja e Efikasitetit të Gjyqtarëve në zgjidhjen e lëndëve për kundërvajtje për një muaj në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Podujevë, Lipjan dhe Drenas (2016, 2017 dhe 2018)⁵⁵




Grafikoni 12. Mesatarja e Efikasitetit të Gjyqtarëve në zgjidhjen e lëndëve për kundërvajtje për një muaj në Gjykatën Themelore në Gjiilan dhe degët e saj –Kamenicë, Viti dhe Novobërdë (2016, 2017 dhe 2018)


⁵⁵ Vërejtje: Në bazë të të dhënave të KGJK – së, dega në Graçanicë nuk trajton fare lëndë të kundërvajtjeve.




Grafikoni 13. Mesatarja e Efikasitetit të Gjyqtarëve në zgjidhjen e lëndëve për kundërvajtje për një muaj në Gjykatën Themelore në Prizren dhe degët Dragash dhe Suharekë (2016, 2017 dhe 2018)




Grafikoni 14. Mesatarja e Efikasitetit të Gjyqtarëve në zgjidhjen e lëndëve për kundërvajtje për një muaj në Gjykatën Themelore në Mitrovicë dhe degët e saj – Vushtrri dhe Skenderaj (2016, 2017 dhe 2018)



Grafikoni 15. Mesatarja e Efikasitetit të Gjyqtarëve në zgjidhjen e lëndëve për kundërvajtje për një muaj në Gjykatën Themelore në Gjakovë dhe degët e saj – Malishevë dhe Rahovec (2016, 2017 dhe 2018)



Grafikoni 16. Mesatarja e Efikasitetit të Gjyqtarëve në zgjidhjen e lëndëve për kundërvajtje për një muaj në Gjykatën Themelore në Pejë dhe degët Istog, Klinë dhe Deçan (2016, 2017 dhe 2018)



Grafikoni 17. Mesatarja e Efikasitetit të Gjyqtarëve në zgjidhjen e lëndëve për kundërvajtje për një muaj në Gjykatën Themelore në Ferizaj dhe degët e saj – Kaçanik dhe Shtërpcë (2016, 2017 dhe 2018)

6.3. Numri i lëndëve kundërvajtëse të parashkuara përgjatë viteve 2016, 2017 dhe 2018


Në bazë të të dhënave të pranura nga KGJK – ja lidhur me numrin e lëndëve kundërvajtëse të parashkuara në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe degët e saj, përgjatë viteve 2016, 2017 dhe 2018, më poshtë është paraqitur grafiki kjo situatë për secilën gjykatë me degët e saj veç e veç.⁵⁶

E në bazë të këtyre statistikave, vërehet qartë se lëndët e kundërvajtjeve ballafaqohen me një numër të madh të parashkrimeve përgjatë viteve, që varion shumë nga një gjykatë në tjetrën, por që i dukshëm është fakti se shkalla më e lartë e parashkrimeve në gjykatat e vendit është shënuar në vitin 2017.


Ndërsa, vlen të ceket se Gjykata e Mitrovicës prin me numrin më të lartë të parashkrimeve për periudhën kohore 2016 – 2018, me 40,582 parashkrime gjithsej. Pas saj vjen Ferizaj me 39,578 lëndë të parashkuara për 3 vjet. Kurse, Prishtina radhitet e treta në këtë drejtim, me 28,956 lëndë të parashkuara gjatë viteve 2016, 2017 dhe 2018.

Në aspektin pozitiv vlen të përmenden sidomos Dragashi dhe Vushtrria, si dy degë që përgjatë tre vjetëve të fundit nuk kanë lënë të parashkruhet asnjë lëndë kundërvajtëse. Ndërsa, nga gjykatat themelore më së miri qëndron Peja me gjithsej 5 lëndë kundërvajtëse të parashkuara, 0 në vitin 2016, 1 në vitin 2017 dhe 4 më 2018.


⁵⁶ Korrespondenca përmes postës elektronike me Departamentin e Statistikës në KGJK. 15 Shkurt, 2019.




Grafikoni 18. Numri i përgjithshëm i lëndëve të kundërvajtjeve të parashkuara në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe degët Podujevë, Lipjan dhe Drenas (përgjatë viteve 2016, 2017 dhe 2018)




Grafikoni 19. Numri i përgjithshëm i lëndëve të kundërvajtjeve të parashkuara në Gjykatën Themelore në Gjilan dhe degët e saj –Kamenicë, Viti dhe Novobërdë (2016, 2017 dhe 2018)




Grafikoni 20. Numri i përgjithshëm i lëndëve të kundërvajtjeve të parashkuara në Prizren dhe degët e saj – Dragash dhe Suharekë (2016, 2017 dhe 2018)




Grafikoni 21. Numri i përgjithshëm i lëndëve të kundërvajtjeve të parashkuara në Mitrovicë dhe degët e saj – Vushtri dhe Skenderaj (2016, 2017 dhe 2018)



Grafikoni 22. Numri i përgjithshëm i lëndëve të kundërvajtjeve të parashkuara në Gjakovë dhe degët e saj – Malishevë dhe Rahovec (2016, 2017 dhe 2018)



Grafikoni 23. Numri i përgjithshëm i lëndëve të kundërvajtjeve të parashkuara në Pejë dhe degët e saj – Istog, Klinë dhe Deçan (2016, 2017 dhe 2018)



Grafikoni 24. Numri i përgjithshëm i lëndëve të kundërvajtjeve të parashkuara në Ferizaj dhe degët e saj – Kaçanik dhe Shtërpcë (2016, 2017 dhe 2018)

6.4. Numri i lëndëve kundërvajtëse të parashkuara brenda një dite pune ne gjykatat e vendit

IKD po ashtu ka përllogaritur numrin e lëndëve të cilat parashkruhen në divizionin për kundërvajtje vetëm brenda një dite pune. Kështu, për të llogaritur se sa lëndë të kundërvajtjeve janë parashkuar gjatë një dite në gjykatat tona, kemi marrë për bazë numrin e lëndëve të parashkuara gjatë një viti dhe numrin e ditëve të punës gjatë atij viti.


Kështu, në vitin 2016 nga 366 ditë sa ka pasur viti, 105 prej tyre kanë qenë vikend (e shtunë dhe e diel), kurse 11 kanë qenë festa zyrtare⁵⁷, që do të thotë se në total kanë qenë 250 ditë pune gjatë atij viti. Me të njëjtën llogaritje, në vitin 2017 rezulton të kenë qenë 249 ditë pune. Nga 365 ditë sa ka pasur ai vit, kemi hequr 105 ditë të vikendit dhe 11 ditë të festave zyrtare⁵⁸. Ndërsa, në vitin 2018, nga 365 ditë të vitit, 104 sosh kanë qenë vikend dhe 11 festa zyrtare⁵⁹, që do të thotë se kanë qenë gjithsej 250 ditë pune.

Më pas, numri i lëndëve të kundërvajtjeve të parashkuara për secilën gjykatë (i siguruar nga Departamenti i Statistikës në KGJK), është përpjesëtuar me numrin e ditëve të punës për secilin vit respektiv dhe ka ardhur deri tek rezultati i paraqitur me grafikonet e mëposhtme.


⁵⁷ Ministria e Administratës Publike në Republikën e Kosovës. “Kalendari i Festave Zyrtare 2016”. (shih linkun <https://map.rks-gov.net/institucion/Calendar-of-Oficial-Holidays/Kalendari-i-festave-2016.aspx>)

⁵⁸ Ministria e Administratës Publike në Republikën e Kosovës. “Kalendari i Festave Zyrtare 2017”. (shih linkun <https://map.rks-gov.net/institucion/Calendar-of-Oficial-Holidays/Kalendari-i-festave-2017.aspx>)


⁵⁹ Ministria e Administratës Publike në Republikën e Kosovës. “Kalendari i Festave Zyrtare 2018”. (shih linkun [https://map.rks-gov.net/institucion/Calendar-of-Oficial-Holidays/Kalendari-i-festave-2017-\(1\).aspx](https://map.rks-gov.net/institucion/Calendar-of-Oficial-Holidays/Kalendari-i-festave-2017-(1).aspx))




Grafikoni 25. Mesatarja e parashkrimit të lëndëve të kundërvajtjeve brenda një dite në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe degët Podujevë, Lipjan dhe Drenas (përgjatë viteve 2016, 2017 dhe 2018)




Grafikoni 26. Mesatarja e parashkrimit të lëndëve të kundërvajtjeve brenda një dite në Gjykatën Themelore në Gjilan dhe degët e saj –Kamenicë, Viti dhe Novobërdë (2016, 2017 dhe 2018)




Grafikoni 27. Mesatarja e parashkrimit të lëndëve të kundërvajtjeve brenda një dite në Gjykatën Themelore në Prizren dhe degët Dragash dhe Suharekë (2016, 2017 dhe 2018)




Grafikoni 28. Mesatarja e parashkrimit të lëndëve të kundërvajtjeve brenda një dite në Gjykatën Themelore në Mitrovicë dhe degët e saj – Vushtrri dhe Skenderaj (2016, 2017 dhe 2018)



Grafikoni 29. Mesatarja e parashkrimit të lëndëve të kundërvajtjeve brenda një dite në Gjykatën Themelore në Gjakovë dhe degët e saj – Malishevë dhe Rahovec (2016, 2017 dhe 2018)



Grafikoni 30. Mesatarja e parashkrimit të lëndëve të kundërvajtjeve brenda një dite në Gjykatën Themelore në Pejë dhe degët Istog, Klinë dhe Deçan (2016, 2017 dhe 2018)



Grafikoni 31. Mesatarja e parashkrimit të lëndëve të kundërvajtjeve brenda një dite në Gjykatën Themelore në Ferizaj dhe degët e saj – Kaçanik dhe Shtërpçë (2016, 2017 dhe 2018)

6.5. Roli i KGJK – së dhe masat e ndërmarra kundrejt parashkrimit të lëndëve të kundërvajtjes

Për sa i përket parashkrimit, si një çështje mjaft e spikatur për sistemin e drejtësisë, në mbledhjen e 194 – të të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, të mbajtur me datën 13 dhjetor 2017, ishte diskutuar për mbylljen e lëndëve të kundërvajtjeve, të cilat kanë arritur afatin e parashkrimit, por që ende qëndrojnë pjesë e lëndëve të inventarit në pritje, si lëndë të hapura. Gjatë këtij diskutimi ishte thënë se statistikat e gjyqësorit të Kosovës fryhen padrejtësisht me numër të lëndëve të papërfunduara, sidomos nga ato kundërvajtëse. Andaj, u kërkua që të gjitha lëndët e natyrës kundërvajtëse të cilat e kanë arritur parashkrimin, si për ndjekje ashtu edhe për ekzekutim të sanksionit kundërvajtës, të mbylljen, d.m.th. të përfundohen dhe të hiqen një herë e përgjithmonë, e të mos njihen si lëndë të hapura – aktive.⁶⁰

Në fund të kësaj mbledhje ishte miratuar Vendimi nr. 358/17, që përfshinte 6 pika:⁶¹

- I. Gjyqtarët e Divizionit të Kundërvajtjes, duhet të mbyllin të gjitha lëndët e Kundërvajtjes që sipas Ligjit kanë arritur afatin e parashkrimit, e të cilat akoma evidentohen në inventarin e lëndëve në pritje (si lëndë të hapura).
- II. Afati i fundit për mbylljen e lëndëve të kundërvajtjes, sipas paragrafit I të këtij Vendimi është data 28 shkurt 2018.

⁶⁰ Diskutimi përgjatë mbledhjes nr. 194 të KGJK – së, e mbajtur më 13 dhjetor 2017.

⁶¹ KGJK. “Vendim nr. 358/17”. Prishtinë, 13 Dhjetor 2019.

- III. Për zbatimin e këtij Vendimi, gjyqtarët duhet të pranojnë ndihmë nga praktikantët dhe stafi mbështetës i gjykatës.
- IV. Gjyqtarët e Divizionit për Kundërvajtje, në baza javore t'i raportojnë kryetarit të gjykatës, përkatësisht gjyqtarit mbikëqyrës të degës për progresin e arritur.
- V. Kryetarët e gjykatave dhe gjyqtarët mbikëqyrës të degëve, t'i raportojnë Komisionit për Administrimin e Gjykatave të Këshillit Gjyqësor për rezultatet e arritura rreth zbatimit të këtij Vendimi, përfundimisht deri me datën 15 mars 2018.
- VI. Obligohet Komisioni për Administrimin e Gjykatave për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij Vendimi dhe paraqitjen e raportit gjithëpërfshirës në Këshillin Gjyqësor të Kosovës deri më datë 31 mars 2017.

Ndërkaq edhe arsyetimi i këtij vendimi tregon saktësisht gjendjen e lëndëve të kundërvajtjeve, ku thuhet “përgjatë viteve të kaluara, numri i lëndëve të kundërvajtjes është rritur vazhdimisht. Numri i madh i këtyre lëndëve, përveç të tjerash ka ndikuar edhe në imazhin e gjyqësorit, duke rritur numrin e përgjithshëm të lëndëve në pritje për t’u zgjidhur”.⁶²

Sipas përgjegjësve të gjykatave të vendit, ky vendim i KGJK – së është respektuar në tërësi.⁶³

IKD përveç analizimit të shifrave ka tentuar të gjejë edhe arsyet e ekzistimit të një gjendje të tillë të parashkrimeve dhe prandaj ka dërguar pyetje për të intervistuar të gjithë përgjegjësit e shtatë gjykatave themelore në vend.⁶⁴

Në këtë drejtim, një nga arsyet e dhëna lidhej direkt me ligjin e ri për kundërvajtjet. Përkundër lehtësirave për të cilat është thënë se ky ligj ka krijuar për gjyqtarët mbikëqyrës, duket se megjithatë në aspektin e ekzekutimit të gjobave thjesht ka vështirësuar punën edhe më tej. Fakti se me ligji e ri është paraparë heqja e dënimit me burgim dhe mundësia e zëvendësimit të gjobës me këtë lloj dënimi, thuhet se ka bërë që ekzekutimi i gjobave të mbetet në mëshirën e vetë kryerësve.

“Pas hyrjes në fuqi të Ligjit për kundërvajtje (ligji nr. 05/L-087), i cili nuk parasheh dënimin me burg dhe mundësinë e zëvendësimit të gjobës me dënim burgimi për kundërvajtje, është krijuar një gjendje kaotike sepse dënimet-gjobat e shqiptuara nga gjykata për persona fizik dhe person përgjegjës të personave juridik nuk ekzekutohen nëse nuk paguhen në mënyrë vullnetare. Nga hyrja në fuqi e këtij ligji me mija lëndë parashkruhen në ekzekutim, kryesit e veprave mbesin të lirë (pa i paguar gjobat), është rritur në mënyrë drastike numri i përsëritësve të veprave të kundërvajtës dhe është duke shkuar kot puna e organeve ndjekëse si dhe puna e gjykatës... Mendoj se heqja e dënimit me burg për kundërvajtje dhe mundësisë së zëvendësimit të gjobës

⁶² Po aty.

⁶³ Intervistë me kryetarët e gjykatave/gjyqtarët mbikëqyrës të Divizionit për Kundërvajtje në gjykatat themelore.

⁶⁴ Lidhur me këto pyetje, IKD nuk ka marrë përgjigje nga Gjykata Themelore e Mitrovicës, Gjykata Themelore në Prizren dhe as nga Gjykata Themelore në Ferizaj.

me dënim burgimi që është bërë me rastin e miratimit të Ligjit për Kundërvajtje duke menduar se është në kundërshtim me kushtetutën e ka sjellë një gjendje të tillë kaotike.”⁶⁵

Ngjashëm me këtë mendim ishte shprehur edhe Kryetari i Gjykatës Themelore në Pejë, sipas të cilit “lëndët parashkruhen kryesisht për shkak të pamundësisë për ekzekutim të dhunshëm për personat fizik, ndërsa te personat juridik kur kanë mjete në xhirollogari të bankave ekzekutimi është i suksesshëm”.⁶⁶

Por si arsye të parashkrimit të lëndëve, përveç situatës së re të krijuar me ligjin e ri për kundërvajtje, duket se është edhe numri i vogël i gjyqtarëve përgjegjës për lëndë të kësaj natyre.

Sipas Kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, deri tek parashkrimi i lëndëve vjen për shkak të “numrit të madh të lëndëve, në raport me numrin e vogël të gjyqtarëve”.⁶⁷

Ndërsa, Kryetari i Gjykatës së Gjilanit ka vlerësuar se ky numër tashmë nuk përbën shqetësim, meqenëse, sipas tij, ka shënuar rënie, por, ai thotë, se arsye kryesore e arritjes së parashkrimit të lëndëve përbën mos-lokalizimi i shkelësve të veprave të kësaj natyre.

“Në vitet e mëhershme kemi pasur më shumë lëndë të parashkruara, ndërkohë tash këto dy tre vitet e fundit numri i lëndëve të parashkruara në Divizionin e Kundërvajtjes ka rëndë dukshëm. Deri tek parashkrimi janë disa faktor, mirëpo më të shpeshta janë kur pala nuk mund të gjendet apo gjendet jashtë vendit dhe lënda arrin parashkrimin.”⁶⁸

Kjo çështje ishte parë shqetësuese edhe nga Avokati i Popullit, qysh në vitin 2016, kur edhe kishte publikuar një raport me rekomandime lidhur me parashkrimin e procedurave gjyqësore dhe ekzekutimin e vendimeve të Gjykatave Themelore në rastet e kundërvajtjes.

Sipas Avokatit të Popullit, problemi i parashkrimit të rasteve të kundërvajtjes ka pasoja të dëmshme në respektimin e të drejtave të njeriut të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Republika e Kosovës ka obligim kushtetues, sipas KEDNJ-së dhe nenit 53 të Kushtetutës, të sigurojë zbatimin efikas të dispozitave ligjore, përmes ekzekutimit të sanksioneve, për të parandaluar dhe dekurajuar veprat kundërvajtëse që rrezikojnë jetën dhe sigurinë e qytetarëve të Republikës, sidomos në fushën e komunikacionit rrugor. Statistikat e Policisë tregojnë se rrezikshmëria e komunikacionit rrugor është duke u rritur në mënyrë alarmante.⁶⁹

⁶⁵ Intervistë me Gjyqtarin mbikëqyrës të Divizionit për Kundërvajtje në Gjykatën Themelore në Prishtinë, z. Mustafë Selimi. 28 shkurt 2019.

⁶⁶ Intervistë me Kryesuesin e Divizionit për Kundërvajtje në Gjykatën Themelore në Pejë, z. Kadri Prekaj. 6 mars, 2019.

⁶⁷ Intervistë me Kryetarin e Gjykatës Themelore në Gjakovë, z. Vaton Durguti. 12 mars, 2019.

⁶⁸ Intervistë me Kryetarin e Gjykatës Themelore në Gjilan, z. Ramiz Azizi. 5 mars, 2019.

⁶⁹ Institucioni i Avokatit të Popullit. “Raport me rekomandime Ex officio nr. 239/2016 – Raport lidhur me parashkrimin e procedurave gjyqësore dhe ekzekutimin e vendimeve të Gjykatave Themelore në rastet e kundërvajtjes”. Prishtinë. 25 Prill, 2016. (Shih linkun: <https://dokumen.tips/documents/institutivioni-i-avokatit-t-popull-e-raporteve-me-rekomandime-2-raport-lidhur.html>)

Fakti se gati 20% të rasteve të kundërvajtjes përfundojnë në parashkrim, do të thotë se vozitës të papërgjegjshëm po mbeten të padënuar dhe plotësisht të lirë të vazhdojnë sjelljet e tyre të rrezikshme nëpër rrugët e Republikës. Në këto rrethana, efekti parandalues i “sanksionimit të shkeljeve të dispozitave [ligjore]” për këta vozitës, si dhe efekti dekurajues i këtyre sanksioneve për vozitësit në përgjithësi, nuk po funksionojnë siç duhet. Për këtë arsye, parashkrimi i lëndëve kundërvajtëse, qoftë në fazën e procedurës gjyqësore qoftë në fazën e ekzekutimit të sanksioneve, jo vetëm që ka impakt të madh në buxhetin e shtetit, por edhe e pengon Republikën e Kosovës në përmbushjen e obligimit të saj “primar” për të siguruar të drejtën e jetës dhe sigurisë së qytetarëve dhe banorëve të vet, duke siguruar efektin parandalues dhe dekurajues të rregullave kundërvajtëse të komunikacionit rrugor.⁷⁰

Po ashtu, sipas raportit të publikuar, parashkrimi i rasteve të kundërvajtjes në masë të madhe, paraqet shkelje të së drejtës së pronës të atyre që paguajnë gjobën sepse, në rrethanat aktuale, ku afërsisht 20% të gjobave të vendosura parashkruhen, çështja se kush e paguan dënimin dhe kush jo, bëhet plotësisht arbitrare. Le të supozojmë, si rast hipotetik, që tre persona gjobiten nga Policia për të njëjtën vepër kundërvajtëse në të njëjtën datë, por në qendra të ndryshme rajonale të Republikës. Lënda e personit të parë dëgjohej nga Gjykata Themelore përkatëse, gjoba konfirmohet nga Gjykata dhe i gjobituri e paguan gjobën pa vonesë. Lënda e personit të dytë dëgjohej gjithashtu nga Gjykata Themelore në qendrën rajonale ku banon ai dhe, njësoj si në lëndën e personit të parë, gjoba konfirmohet nga Gjykata. Mirëpo, i gjobituri në këtë rast nuk paguan gjobën me iniciativën e vet dhe, për më tepër, nuk ka adresë të saktë. Për këtë arsye, Policia nuk e gjen dot, një vit kalon dhe i gjobituri lirohet nga pagimi i gjobës për shkak të parashkrimit të ekzekutimit të sanksionit. Ndërsa, lënda e personit të tretë ngelet e pashqyrtuar fare nga gjykata për më shumë se një vit, sepse Gjykata Themelore në rajonin ku banon është e mbingarkuar me lëndë kundërvajtëse. Për rrjedhojë, lënda nuk dëgjohej, parashkruhet që në fazën procedurale dhe personi i tretë, si personi i dytë, lirohet nga pagimi i gjobës së vendosur. Ky rast hipotetik tregon qartë se vuajtja e dënimit të gjobës, kur parashkrimi i rasteve të kundërvajtjes ndodh në masë të madhe ashtu si në rrethanat aktuale të Republikës së Kosovës, është arbitrare dhe, si e tillë, nuk përmbush kriteret e sigurisë ligjore. Prandaj, problemi i parashkrimit të rasteve, pengon respektimin e plotë të së drejtës së pronës për të mos u privuar nga prona në mënyrë arbitrare.⁷¹

IKD ka kërkuar të dijë edhe nga KGJK – ja nëse gjatë kësaj periudhe kohore tre vjeçare ka pasur ndonjë masë disiplinore kundër gjyqtarëve të Departamentit të Përgjithshëm – Divizioni për Kundërvajtje, për shkak të parashkrimit të lëndëve.

Në përgjigjen e pranuar është thënë se lidhur me këtë çështje nuk janë marrë masa nga institucionet përkatëse. Madje, gjatë vitit 2016, Komisioni Disiplinor i KGJK – së nuk ka zhvilluar ndonjë procedurë disiplinore ndaj gjyqtarëve të Departamentit të Përgjithshëm – Divizioni për Kundërvajtje.

⁷⁰ Po aty.

⁷¹ Po aty.

Në vitin 2017 Komisioni Disiplinor pasi ka pranuar raportin përfundimtar nga Zyra e Prokurorit Disiplinor më të cilin raport është dyshuar për sjellje të pahijshme të mundshme të një ish gjyqtari mbikëqyrës së një Gjykate Themelore, ku si rezultat i neglizhencës së menaxhimit të degës së Gjykatës, nuk ka vepruar në përputhje me përgjegjësitë administrative lidhur me regjistrimin e më shumë se tetë mijë (8000) lëndë të natyrës kundërvajtësve të vitit 2016.

Komisioni Disiplinor pasi i ka administruar të gjitha provat në shkresat e lëndës, parashtresat e dorëzuara nga ZPD – ja të cilat nuk kanë qenë të bashkëngjitura në raportin përfundimtar, i ka shqyrtuar dhe analizuar të gjitha provat dhe deklaratën e gjyqtarit në fjalë dhe ka konstatuar se ekziston përgjegjësi e rëndë disiplinore e gjyqtarit. Sipas vlerësimit të Komisionit qëndron pretendimi i ZPD-së se ish Gjyqtari Mbikëqyrës në atë Degë është dashur që me një angazhim më të madh, të kërkojë staf mbështetës ashtu siç edhe ka ndodhur në fillim të vitit 2017, ku të gjitha lëndët janë regjistruar.

Në seancën për këshillim dhe votim Komisioni njëzëri vendosi se ky gjyqtar është përgjegjës për sjellje të pahijshme të një gjyqtari sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2 – neglizhencë në kryerjen e detyrave, dështim për të kryer, apo keqpërdorim i funksioneve gjyqësore, si dhe 1.4 – shkelje e kodeve të zbatueshme të etikës. Lidhur me këtë, Komisioni në seancën për këshillim dhe votim, në mënyrë unanime i ka shqiptuar masën disiplinore Ulje e përkohshme e rrogës për 25% në kohëzgjatje prej katër (4) muajve.

Në vitin 2018, Komisioni Disiplinor i KGJK – së ka zhvilluar procedurë disiplinore ndaj një gjyqtari të Divizionit për kundërvajtje. Pasi ka mbajtur seancën dëgjimore, e ka dëgjuar përfaqësuesin e ZPD dhe Gjyqtarin, ka analizuar të gjitha provat e bashkëngjitura raportit përfundimtar nga ZPD, deklaratën e Gjyqtarit, në seancën për këshillim dhe votim Komisioni njëzëri vendosi së ky gjyqtar është përgjegjës për sjellje të pahijshme të një gjyqtari sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2 – neglizhencë në kryerjen e detyrave, dështim për të kryer dhe shkelje e Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtar pika II e preambulës, pika 1, 1.4, pika 5, e përcaktuar si shkelje e lehtë e pahijshme nga neni 4 lidhur me nenin 6 të Rregullores nr.04/2016 Për Përcaktimin e sjelljeve të Pahijshme. Lidhur me këtë konstatim, Komisioni në mënyrë unanime i ka shqiptuar masën disiplinore Ulje e përkohshme e rrogës për 20% në kohëzgjatje prej tre (3) muajve.⁷²

Që të kemi një pasqyrë më të qartë të kësaj situate të parashkrimit të lëndëve kundërvajtëse në Kosovë, IKD në vijim ka analizuar të dhënat e përgjithshme, nga të cilat më pas ka nxjerrë gjetje konkrete të cilat pastaj janë paraqitur grafikisht, për secilën gjykatë me degët e saj veç e veç, mbi numrin e lëndëve të pazgjidhura në fund të secilit vit, efikasitetin real të gjykatave, si dhe parashkrimin e këtyre lëndëve në secilën gjykatë në vend, përfshirë edhe paraqitjen statistikore të parashkrimit të këtyre lëndëve vetëm brenda një dite.

⁷² Korrespondenca përmes postës elektronike me KGJK – në, 4 mars, 2019.

7. Humbjet e shtetit nga parashkrimet e lëndëve kundërvajtëse

Një fakt tjetër mjaft shqetësues në krejt këtë mes është pikërisht edhe humbja e milionave të investimeve nga buxheti i shtetit si rrjedhojë e parashkrimit të lëndëve. Për të pasqyruar konkretisht gjendjen e tillë, IKD ka përllogaritur dhe ka nxjerrë një mesatare mbi vlerën e humbur si rrjedhojë e parashkrimit të lëndëve të natyrës kundërvajtëse në gjykatat e vendit.

Për të arritur deri tek kjo llogaritje, IKD ka kërkuar përgjigje nga 7 gjykatat themelore në vend mbi vlerën e saktë, ose një vlerë mesatare të gjobave të shqiptuara në procedurat kundërvajtëse, përgjatë vitit 2016, 2017 dhe vitit 2018. Mirëpo, të dhëna të plota lidhur me pyetjet tona kemi marrë vetëm nga Gjykata Themelore në Prishtinë dhe ajo në Gjiilan.⁷³

Rrjedhimisht, në pamundësi të përllogaritjes së vlerës totale të shumës së të hollave që humbin si rrjedhojë e parashkrimit të lëndëve kundërvajtëse, IKD ka nxjerrë një vlerë të tillë, bazuar vetëm në të dhënat e pranura nga Gjykata Themelore në Prishtinë, si gjykata më reprezentative në vend.

Në vitin 2018, nga 93,975 lëndë të zgjidhura nga të gjitha gjykatat e vendit, janë shqiptuar 32,791 gjoba, ndërsa janë parashkruar 40,501 lëndë.⁷⁴ Kështu, nëse prej 93,975 lëndëve janë shqiptuar 32,791 gjoba, kjo i bie se në rreth 35% të rasteve të zgjidhura janë shqiptuar gjoba (pjesa tjetër janë zgjidhur në mënyra të tjera). Tash nga 40,501 lëndët e parashkruara, nëse themi se në 35% të këtyre rasteve do të shqiptoheshin gjoba, i bie që të paktën në 14,175 raste do të shqiptoheshin gjoba.

Në rastin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, gjatë vitit 2018, nga 6,491 gjobat e shqiptuara⁷⁵ janë inkasuar 551,636.88€⁷⁶. D.m.th. vlera mesatare e një gjobe të shqiptuar gjatë këtij viti ka qenë rreth 85€

Rrjedhimisht, nëse marrim për bazë vlerën prej 85€ si vlerë reprezentative e gjobave të shqiptuara nga gjykatat e vendit tonë përgjatë 2018 – s në rastet e kundërvajtjeve, i bie se gjatë vitit 2018, si rrjedhojë e parashkrimit të lëndëve të kundërvajtjeve buxheti i shtetit ka humbur 1,204,875.00€

Në vitin 2017 janë zgjidhur 219,554 lëndë nga të gjitha gjykatat në vend, janë shqiptuar 90,725 gjoba, ndërsa janë parashkruar 70,053 lëndë.⁷⁷ Kjo i bie se nga gjykatat e vendit tonë, përgjatë

⁷³ IKD nuk ka marrë përgjigje nga Gjykata Themelore e Mitrovicës, Gjykata Themelore në Prizren dhe as nga Gjykata Themelore në Ferizaj. Kurse, nga Gjykata Themelore në Gjakovë në përgjigjen e dhënë na është thënë se nuk kanë informata të përpunuara lidhur me këto pyetje.

⁷⁴ Korrespondenca përmes postës elektronike me Departamentin e Statistikës në KGJK. 15 Shkurt, 2019.

⁷⁵ Korrespondenca përmes postës elektronike me Departamentin e Statistikës në KGJK. 15 Shkurt, 2019.

⁷⁶ Intervistë me Gjqqtarin mbikëqyrës të Divizionit për Kundërvajtje në Gjykatën Themelore në Prishtinë, z. Mustafë Selimi. 28 shkurt 2019.

këtij viti, në 41% të rasteve janë shqiptuar gjoba. Pra nëse nga 70,053 lëndët e parashkuara në 41% të tyre do shqiptoheshin gjoba, atëherë në 28,721 raste nga to do të shqiptoheshin gjoba.

Duke marrë parë për bazë Gjykatën në Prishtinë, nga të dhënat e siguruar nga IKD, rezulton se gjatë vitit 2017, nga kjo gjykatë janë shqiptuar 10,650 gjoba⁷⁸ nga të cilat janë inkasuar 250,222.00€⁷⁹. D.m.th. vlera mesatare e një gjobe të shqiptuar gjatë këtij viti ka qenë rreth 23.5€

Rrjedhimisht, nëse marrim për bazë vlerën prej 23.5€ si vlerë reprezentative e gjobave të shqiptuara nga gjykatat e vendit tonë përgjatë 2017 – s në rastet e kundërvajtjeve, i bie se gjatë vitit 2017, si rrjedhojë e parashkrimit të lëndëve të kundërvajtjeve buxheti i shtetit ka humbur 674,943.5€

Kurse, në vitin 2016, në të gjitha gjykatat e vendit janë zgjidhur 377,114 lëndë, janë shqiptuar 188,053 gjoba, e janë parashkuar 60,183 lëndë.⁸⁰ Kjo i bie se gjykatat e vendit tonë, përgjatë këtij viti, në rreth 50% të rasteve kanë shqiptuar gjoba. Pra nëse nga 60,183 lëndët e parashkuara në 50% të tyre do shqiptoheshin gjoba, atëherë në 30,091 raste nga to do të shqiptoheshin gjoba.

Nga të dhënat e ofruara për IKD nga Gjykata Themelore në Prishtinë, rezulton se gjatë vitit 2016, nga kjo gjykatë janë shqiptuar 35,569 gjoba⁸¹ nga të cilat janë inkasuar 322,201.50€⁸². D.m.th. vlera mesatare e një gjobe të shqiptuar gjatë këtij viti ka qenë rreth 9.05€

Rrjedhimisht, nëse marrim për bazë vlerën prej 9.05€ si vlerë reprezentative e gjobave të shqiptuara nga gjykatat e vendit tonë përgjatë 2016 – s në rastet e kundërvajtjeve, i bie se gjatë vitit 2016, si rrjedhojë e parashkrimit të lëndëve të kundërvajtjeve buxheti i shtetit ka humbur 272,323.55€

⁷⁷ Korrespondenca përmes postës elektronike me Departamentin e Statistikës në KGJK. 15 Shkurt, 2019.

⁷⁸ Po aty.

⁷⁹ Intervistë me Gjyqtarin mbikëqyrës të Divizionit për Kundërvajtje në Gjykatën Themelore në Prishtinë, z. Mustafë Selimi. 28 shkurt 2019.

⁸⁰ Korrespondenca përmes postës elektronike me Departamentin e Statistikës në KGJK. 15 Shkurt, 2019.

⁸¹ Po aty.

⁸² Intervistë me Gjyqtarin mbikëqyrës të Divizionit për Kundërvajtje në Gjykatën Themelore në Prishtinë, z. Mustafë Selimi. 28 shkurt 2019.



Grafikoni 32. Vlera e shumës së të hollave të humbura nga buxheti i shtetit si pasojë e parashkrimit të lëndëve të kundërvajtjeve (2016, 2017 dhe 2018)

Grafikoni i mësipërm e paraqet në vlerë monetare gjendjen e parashkrimit të lëndëve të kundërvajtjeve në të gjitha gjykatat e vendit, përgjatë periudhës kohore të tri viteve të fundit. Ndërsa, nëse mbledhim të tri këto shifra për të nxjerrë vlerën totale të shumës së humbur përgjatë këtyre tri viteve të fundit, atëherë mund të themi se buxheti i shtetit ka humbur rreth 2,152,142.05€ të mundshme për t'u inkasuar.

8. Gjetjet lidhur me trajtimin e rasteve të kundërvajtjes nga gjykatat në vendin tonë

- Viti 2018 ka rënie (sasiore) të lëndëve kundërvajtëse të pranuar në gjykata** – Nga të gjitha të dhënat e analizuar dhe paraqitura edhe në mënyrë grafike në këtë raport, vërehet qartë se në vitin 2018, numri i lëndëve të pranuar në gjykatat themelore të vendit ka shënuar rënie të dukshme.

Kjo tregon se Ligji i ri për Kundërvajtje me autorizimet që i ka dhënë edhe organeve administrative për shqiptimin e gjobave, ka bërë që numri i lëndëve të kësaj natyre në gjykatat e vendit, të zvogëlohet. Megjithatë, edhe përkundër këtij ndikimi, efikasiteti ka qenë në shkallën më të ulët për tri vitet e fundit.

- Trendi i efikasitetit të punës së gjykatave në vend bën që të krijohet përshtypja se punohet vetëm për statistika** – në raportet vjetore të KGJK – së divizioni i kundërvajtjes gjithmonë e tejkalon 100% të efikasitetit, kjo për shkak të metodës që përdoret për llogaritjen e tij, sepse nëse analizohet numri i lëndëve të pranuar dhe ai i lëndëve të zgjidhura në fund të çdo viti, del se gjyqtarët pothuajse çdo vit kryejnë më

shumë lëndë sesa që pranojnë gjatë atij viti.

Por në kohën kur lëndët e pranuar në gjykatë shënojnë rënie, bashkë me to rënie shënon edhe numri i lëndëve të kryera nga një gjyqtar brenda një muaji. Kjo të bën të mendosh se punohet vetëm për tejkalimin e numrit të lëndëve të pranuar për atë vit, e jo në tërësi të vazhdojë zgjidhja e lëndëve me ritmin e njëjtë sikurse në vitet paraprake. Rrjedhimisht në fund nuk zgjidhen mjaftueshëm lëndë dhe mbesin shumë sosh të pakryera nga ato që janë në punë.

- 3. Moszgjidhja/vonesat në zgjidhjen e lëndëve të kundërvajtjeve ndikojnë negativisht tek organet e tjera përgjegjëse të kësaj natyre** – praktika ka treguar se përkundër vullnetit dhe përkushtimit të institucioneve të tjera kompetente, në raste të caktuara, dështimi i hallkës së gjyqësorit ka bërë që të dështojë edhe puna e tyre.

Sipas personave përgjegjës të këtyre institucioneve, të trajtuara në pjesën e parë të punimit, vonesa në trajtimin dhe zgjidhjen e lëndëve nga ana e gjykatës, apo edhe mos shqiptimi i gjobave nga gjykatat, ka bërë që të dëmtohet edhe autoriteti i tyre dhe të humbet qëllimi i trajtimit të këtyre rasteve. Madje, sipas tyre, edhe nëse vjen deri tek shqiptimi i ndonjë gjobe, praktika ka treguar se gjykatat kanë zvogëluar gjobat deri në shumën të parëndësishme të të hollave në raport me shkeljen dhe kryerësin.

- 4. Në gjykatat e Kosovës përgjatë viteve 2016, 2017 dhe 2018 janë parashkruar një numër i madh i lëndëve kundërvajtëse** – çështja e parashkrimit gjithmonë është një nga temat më të diskutuara kur flitet për sistemin e drejtësisë në Kosovë. Arsyetime nga më të ndryshme vijnë nga akterët kryesorë lidhur me atë se përse vjen deri tek ky fenomen. Megjithatë është e ditur se lëndët e kundërvajtjeve ballafaqohen me një numër të madh të parashkrimeve përgjatë viteve, që varion shumë nga një gjykatë në tjetrën, por që shkalla më e lartë e parashkrimeve në gjykatat e vendit është shënuar në vitin 2017. Në këtë drejtim, vetëm atë vit janë parashkruar 70,053 lëndë kundërvajtëse. Në vitin paraprak, 2016, ishin parashkruar 60,183 lëndë, ndërsa më 2018 janë parashkruar 40,501 lëndë kundërvajtëse.

Vlen të ceket se Gjykata e Mitrovicës prin me numrin më të lartë të parashkrimeve për periudhën kohore 2016 – 2018, me 40,582 parashkrime gjithsej. Pas saj vjen Ferizaj me 39,578 lëndë të parashkruara për këto 3 vjet. Kurse, Prishtina radhitet e treta në këtë drejtim, me 28,956 lëndë të parashkruara përgjatë kësaj periudhe.

Në aspektin pozitiv vlen të përmenden sidomos Dragashi dhe Vushtrria, si dy degë që përgjatë tre vjetëve të fundit nuk kanë lënë të parashkruhet asnjë lëndë kundërvajtëse. Ndërsa, nga gjykatat themelore më së miri qëndron Peja me gjithsej 5 lëndë kundërvajtëse të parashkruara, 0 në vitin 2016, 1 në vitin 2017 dhe 4 më 2018.

5. **Ligji i ri për kundërvajtje ka ndikuar negativisht në ekzekutimin e gjobave** – Sado që ky ligj është diskutuar mjaft dhe përkundër faktit se pikërisht për atë që është diskutuar – autorizimet shtesë për organet administrative, në realitet kanë lehtësuar dukshëm punën e gjyqtarëve, megjithatë fakti që me ligjin e ri është hequr dënimin me burgim, ka pasur një ndikim të madh. Ky ndryshim ka bërë që ekzekutimi i gjobave të mbetet në mëshirën e vetë kryerësve. Rrjedhimisht, sipas gjykatësve për kundërvajtje në Kosovë, një numër i madh i lëndëve parashkruhen në ekzekutim, rritet numri i recidivistëve dhe puna e institucioneve të caktuara dështon.

6. **Humbjet që i shkaktohen shtetit nga parashkrimi i lëndëve kundërvajtëse** – Numri i lëndëve të parashkruara dhe rënia e efikasitetit bëjnë që investimet dhe iniciativat e tjera shtetërore në drejtim të trajtimit të kundërvajtjeve të dështojnë tërësisht. Kështu nga llogaritjet e bëra, rezulton që gjatë vitit 2018, si rrjedhojë e parashkrimit të lëndëve të kundërvajtjeve buxheti i shtetit ka humbur rreth 1,204,875.00€ Në vitin 2017 ka humbur rreth 674,943.5€ kurse më 2016 rreth 272,323.55€ Apo në total përgjatë këtyre tri viteve rreth **2,152,142.05€** IKD ka nxjerrë këtë vlerë bazuar vetëm në të dhënat e pranuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, si gjykata më reprezentative në vend.

9. Rekomandimet

1. Të rritet efikasiteti i punës së gjyqtarëve duke shfrytëzuar ndryshimet në ligjin për kundërvajtje, do të thotë numrin më të vogël të lëndëve të pranuar, e rrjedhimisht edhe numrin më të vogël të lëndëve në punë;
2. Me ngritje të efikasitetit, të evitohet parashkrimi i lëndëve dhe t'i jepet shtysë edhe organeve të tjera që të jenë sa më efikas;
3. Me qëllim të administrimit të mirë të drejtësisë dhe ruajtjes së buxhetit të Republikës së Kosovës, KGJK duhet që të angazhohet seriozisht në luftimin e dukurisë së parashkrimit të kundërvajtjeve;
4. Organet administrative t'i shfrytëzojnë ndryshimet në Ligjin e ri për Kundërvajtje dhe t'i kryejnë obligimet e tyre në mënyrë të pavarur;
5. Të shfrytëzohen maksimalisht format dhe mundësitë e parapara me legjislacionin pozitiv në Kosovë, në mënyrë që të realizohet ekzekutimi i gjobave.